

## **KËRKESË**

### **PËR SHPALLJEN TË ZHDUKUR TË FATOS GANI DANE**

#### **GJYKATËS SË RRETHIT GRAMSH**

Kërkuese: Merita Dane, e bija e Xhemalit, datëlindja 1973, me banim në lagjen “Sporti”, banesa nr.8 të qytetit të Gramshit.

Objekti: Shpalljen si të zhdukur qysh nga viti 1992 të bashkëshortit Fatos Gani Dane, në bazë të nenit 15 e vijues të Kodit Civil dhe të nenit 375 e vijkues të Kodit të procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëshorti im, Fatos Gani Dane është larguar nga shtëpia ime qysh nga viti 1992, në muajin tetor. Largësia e tij është bërë me qëllim për të shkuar në Greqi për të punuar. Që nga kjo kohë dhe deri më sot nuk kam asnjë informacion për vendndodhjen e tij dhe nëse është gjallë ose jo. Nga martesë me bashkëshortin tim kemi një fëmijë, të seksit mashkull dhe quhet Xhuljan Fatos Dane.

Në vështrim të nenit 15 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë personi që mungon nga vendbanimi i tij dhe për të cilin nuk ka lajme për vendndodhjen e tij me gjithë interesimet e bëra në organet shtetërore të vendit tonë dhe jashtë shtetit në Greqi, nuk kemi marrë asnjë lajm se ku ndodhet dhe nëse është gjallë ose jo, si dhe meqenëse ka mbi dy e më shumë vjet nga koha e largimit të tij nga vendbanimi kërkojmë shpalljen e tij si të zhdukur në rrugë gjyqësore, që nga viti 1992.

Për këtë jemi interesuar edhe me shpalljen nëpërmjet televizionit të Republikës së Shqipërisë, Interpolit dhe kemi marrë përgjigje zyrtare (me gojë se nuk ka të dhëna mbi vendndodhjen e Fatos Danes dhe nëse është gjallë ose jo).

Mbi sa më sipër kërkojmë që të pronaohet kërkesa jonë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gramsh, me qëllim për të vazhduar procedurat e mëtejshme sipas ligjit.

**KËRKUESE**  
**Merita Dane**